



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno 11.07.2024		
Nr. llog. Org. jed.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
15-300/01-004 4981/24		
PODUJEVË - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Bazuar në nenin 62.3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 64 parg.3 dhe 4 të statutit të Komunës nr.01-020/01-50862/18, nenin 18.3 të rregullores për kushtet/kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot: 01-016/01-0030667/22 dhe bazuar ne planin e punës dhe ne buxhetin për vitin 2024, Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik shpall:

FTESË PUBLIKE

për aplikim në projektin:

NGRITJA DHE ZHVILLIMI I BIZNESEVE

(Vazhdim i implementimit të projektit)



Makinë për ballancim të gomave
3 copë



Sharrë, shpejtësia e tehut të sharrës 19/38min,diametri i tehut të sharrës 315mm, këndi mitër -45 - +45°
8 copë



Aparat saldimi CO2, rryma e saldimi: 30 - 250A,
diametri i telit të saldimi: Ø 0.6 - 1.2mm

6 copë

Të drejtë aplikimi kanë:

- Banorë të Komunës së Podujevës – Biznese ekzistuese dhe Start up.

Kushtet për aplikim:

- Biznesi veprimtarinë ta ushtrojë në territorin e Komunës së Podujevës.
- Të mos ketë obligime financiare të papaguara ndaj Komunës dhe ATK-së.

1) BIZNESET EKZISTUESE

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:

- 1) Forma e aplikimit - aplikacioni
- 2) Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit *(në emër të cilit është i regjistruar biznesi)*
- 3) Deklaratë/Çertifikatë e bashkësisë familjare
- 4) Certifikatën e biznesit me informatat e biznesit *(jo më e vjetër se 3 muaj)*
- 5) Vërtetimin e tatimit në pronë *(dëshmi për pagesën e tatimit)*
- 6) Vërtetimin tatimor nga ATK *(dëshmi për pagesën e obligimeve)*
- 7) Deklaratën për bashkëfinancim 30%

Forma e vlerësimit:

Kriteret	Poena
1 Forma e aplikimit - Projekt propozimi;	0-20
2 Vizita në teren;	0-30
3 Dëshmi për përvojë në veprimtarinë aplikuese (Certifikatë/Vërtetim);	10
4 Biznes në pronësi të Gruas	10
5 Aplikues/e (biznese) që nuk kanë përfituar më parë nga ndonjë projekt, thirrje apo ftesë publike të Komunës në vitet (2022,2023 dhe 2024).	30

2) START UP

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:

- 1) Forma e aplikimit - aplikacioni
- 2) Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit
- 3) Deklaratë/Çertifikatë e bashkësisë familjare
- 4) Vërtetimin e Tatimit në pronë *(dëshmi për pagesën e tatimit)*
- 5) Deklaratën për bashkëfinancim 30%


Forma e vlerësimit:

Kriteret	Poena
1 Forma e aplikimit - Projekt propozimi	0-20
2 Vizita në teren;	0-30
3 Dëshmi për përvojë në veprimtarinë aplikuese (Certifikatë/Vërtetim);	10
4 Aplikuese Grua	10
5 Aplikues/e (familje) që nuk kanë përfituar më parë nga ndonjë projekt, thirrje apo ftesë publike të Komunës në vitet (2022,2023 dhe 2024).	30

Aplikimi fillon me datë 11.07.2024 dhe mbaron 31.07.2024, Dokumentet për aplikim mund mirren pranë Drejtorisë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik dhe ato duhet të dorëzohen në zyrën e shërbimit të qytetarëve në Komunën e Podujevës.

VËREJTJE:

- Një aplikant nuk mund të dorëzoj më shumë se një aplikacion në këtë thirrje publike, por në një aplikim mund të bëjë kërkesë për dy pajisje nga pakoja e përgjithshme e ofruar e pajisjeve.
- Për Start-Up aplikimi duhet të bëhet nga personat të cilët synojnë të fillojnë biznesin, jo nga persona të tjerë në emër të tyre dhe pas shpalljes si përfitues duhet regjistruar biznesin.
- Për Biznese ekzistuese aplikimi duhet të bëhet nga pronarët/aksionarët e bizneseve siç figurojnë në certifikatën e ARBK-së apo të autorizuarit e tyre.
- Përfituesit do të marrin pjesë (participim) me 30% të vlerës së projektit.
- Personi fizik apo juridik vetëm një herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga komuna. (neni 6.2 i rregullores së subvencioneve)
- Në bazë të numrit të përgjithshëm të aplikacioneve të pranuara, komisioni gëzon të drejtën të vendos për të subvencionuar bizneset me një apo dy pajisje nga pakoja e përgjithshme e ofruar.
- Në aplikacionet e pranuara evidentohen (aplikues, pronar i biznesit apo familjar të tyre që kanë qenë përfitues në vitet 2022,2023 dhe 2024 nga ndonjë projekt, thirrje apo ftesë publike e Komunës), komisioni varësisht nga numri i përgjithshëm i aplikacioneve të pranuara, gëzon të drejtën të vendos lidhur me shqyrtimin apo mos shqyrtimin e aplikacioneve dhe realizimin e vizitave të tyre në teren.
- Aplikacionet me dokumentacion të pakompletuar dhe të dorëzuara pas afateve kohore nuk do të merren parasysh.



Drejtore i DPZHE:

z. Vigan Salihu